



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 12/6 Prot

Vlorë, më 21 . 07 . 2022.

VENDIM

Nr. 9 , datë 21.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES “KËRKESË PËR RINOVIMIN E LEJES”,
SUBJEKTIT “ENERGO-SAS” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.11 Prot., miratuar nga KBU Vjosë me Vendim Nr.11, datë 23.07.2012 HEC Sasaj, subjektit “Energo-Sas” sh.p.k, me vendndodhje: Burimet e Tatzatit, Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Burimi Ujor: Burimet e Tatzatit

Koordinatat e vendndodhjes së burimit (KRGJSH)

X=494570.6; Y=4432507.8; Z=222 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet për përdorim: Q=3.2 m³ /sek

Prurja mesatare vjetore: Qmes-vj= 2.50 m³ /sek

Prurja ekologjike: Qeko=0.44 m³ /sek

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilën do të përdoret uji: Për prodhim të energjisë elektrike, nëpërmjet Hec-Sasaj.

Koordinatat e vendndodhjes së pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X=490902.7; Y=4429737.4; Z=6.0 m.m.n.d

Fuqia e vendosur Hec Sasaj: N=5500 kwh

Prodhimi mesatar vjetor i energjisë: E= 23 milion kwh

3. Subjekti “Energo-Sas” sh.p.k është i detyruar të ruaj regjimin e ujitjes gjatë sezonit, si më poshtë:

- a) Në periudhën e ujitjes 01 maj -31 tetor të çdo viti, Hec Sasaj nuk punon në qoftëse prurjet janë nën 1.5 m³ /sek ose do të punoj për disa orë në ditë në varësi të prurjeve të burimeve kur ato janë mbi 1.5 m³ /sek, por pa cënuar regjimin e ujitjes.
- b) Të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



K R Y E T A R

FLAMUR MAMAJ